



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.365, Datë 13.11.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN YLLI PJETËRNIKAJ”

Bazuar në nenet 143, 149/a, **germa “e”**, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, **germa “a”** të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, si pedagog, lektor me kohë të pjesshme, për lëndën “E drejta penale”, Pjesa e Përgjithshme, në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Universiteti “Albanian University”, për periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) javësh (tetor 2023 – shkurt 2024).
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Ylli Pjetërnikaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2023.

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

